



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA GLLOGOC



DREJTORIA PËR BUJQËSI PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

THIRRJE PËR APLIKIM

|                      |           |              |       |
|----------------------|-----------|--------------|-------|
| KOMUNA GLLOGOC       |           |              |       |
| GLLOGOC MUNICIPALITY |           |              |       |
| 24. 04               |           | 19           |       |
| Nr. 04               | Numri 400 | Shtesa 21644 | Vlera |

Njoftojmë Fermerët se:

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural i Komunës së Drenasit do të vazhdojë të mbështesë sektorin e Perimeve - me Serra.

Ndërtimi i Serrave ka këto dimensione  $10 \times 5 \times 3.20$  m ( $50 \text{ m}^2$ ), vlera e Serrës do të jetë sipas çmimit të tregut-ofertuesit, 70 % e subvencionimit do të jetë nga Komuna ndërsa participimi i fermerit do jetë 30% nga vlera e përgjithshme e Serrës.

Të drejtë aplikimi në këtë projekt kanë të gjithë fermerët të cilët i plotsojnë kriteret e përcaktuara nga DBPZHR:

1. Të jetë banor rezident i Komunës së Drenasit,
2. Numri identifikues i fermerit (NIF) – (Përparsi fermerët e regjistruar para thirrjes për aplikim)
3. Sipërfaqja e tokës të jetë e mjaftueshme për vendosjen e Serrës dhe e përshtatshme për kultivimin e Perimeve,
4. Lokacioni i Serrës të jetë afër vendbanimit,
5. Të posedojë burim të ujit të mjaftueshëm për ujitjen e Perimeve
6. Fermeri mos të jetë përfitues i projekteve tri vitet e fundit nga DBPZHR, MBPZHR, dhe OJQ,
7. Pjesmarrja 30% e fermerit në momentin e nënshkrimit të kontratës,
8. Përparsi në kushte të barabarta kanë: Zonat rurale, Gratë, të Rinjët, Familjet me gjendje të rëndë Ekonomike, Familjet me gjendje Sociale, Familjet që kanë persona me nevoja të veqanta.

**Me aplikacion duhet të dorëzoni :**

- Kopja e leternjoftimit
- Numri identifikues i fermerit (NIF)
- Fletën poseduese të tokës
- Kopja e vertetimit të gjendjes Sociale ose të Hendikosit të jetë valide nga Institucioni (nese posedon)
- Dëshmia mbi tatimin në pronë
- Të keni gatishmëri për bashkëfinancim me 30 % të projektit

Aplikacioni merret në sektorin e Bujqësisë – Drenas, ndërsa dorëzimi i dokumentacionit të kompletuar bëhet në Zyren Pritëse nr 10, 11, 12 . gjatë orarit të Punës

**Data e aplikimit fillon 24.04.2019 dhe përfundon me date 17.05.2019**

Vërejtje: Dokumentacioni i pa kompletuar nuk merret për shqyrtim.

Drenas 2019



Kryetari i Komunës:

Ramiz Lladrovci